



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Data:	14.10.2022
Për:	Këshillin për Çështje Ligjore
Përmes:	
Nga:	Valmira Selmani/ZL për Regjistrim të PP-ve dhe Certifikim
Kopje:	Arkives
Lënda:	Raporti mbi punën e Kuvendit Zgjedhorë të Partisë Politike, GUXO

Me datën, 07.09.2022, në Hotelin "Emerald", me fillim në ora 17:15, me Ftesë të Partisë Politike Guxo. Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ka monitoruar mbajtjen Kuvendit të I (parë)-Zgjedhore të Partisë Politike Guxo.

Hapjen e Kuvendit të Partisë Politike e moderoi/udhëhoqi znj. Jeta Statovci, Kryetare e Degës në Prishtinë.

Në këtë Kuvend, morën pjesë 521 Delegat.

Në pjesën solemne u intonua Himni zyrtar i Republikës së Kosovës.

Fjala përshëndetës ju dha znj. Donika Gërvalla-Schwarz e cila përshëndeti të pranishmit, dhe në fjalimin e saj tha se një bashkim i përbashkët i të djathtës dhe të majtës siç është Guxo dhe Lëvizja Vetëvendosje-LVV, është e mundur që premtimet e dhëna të mbahen e këtë e ka sjell Vjosa dhe Albini. Znj. Gërvalla-Schwarz tha se data 7 shtatori është një datë e veçantë dhe për këtë kemi vendos datën e Kuvendin të parë themelues ta mbajmë me datën 7 shtator edhe partia politike Guxo. Guxo është të qëndrosh, guxo është të luftosh korrupsionin.

Një fjalë përshëndetës ju dha dhe z. Faton Peci/Ministri i Bujqësisë i cili përshëndeti mysafirët dhe delegatet, ai the se Listës Guxo ju bashkuan shume struktura, data 14 shkurt 2021, sjelli ndryshime ku rendi dhe ligji janë detyrim, sot nuk ka pazare me territorin e Kosovës. z. Peci tha se sot ka Bujqësi të zhvilluar nuk ka interesa, por subvencionet u ipen bujqeve jo personave të tjetër për të përfituar në emrin e bujqve.

Në vazhdim fjala ju dha dhe z. Albin Kurti/Kryeministër i Kosovës, i cili përshëndeti të pranishmit, uroi që zgjedhjet e degëve me angazhim të përbashkët do të ecin përpara për barazi gjinore. z. Kurti tha se kemi ngritur mirëqenien social në Kosovë, tani jemi në realizimin e pakos së dyte për të mbështetur të gjithë qytetaret e Kosovës pasi që kemi pasur inflacion.

***Pas përfundimit të pjesës solemne,***



Kuvendi vazhdoi punën sipas Rendit të ditës, ku pas konsultimeve, diskutimeve dhe propozimeve të bëra, për hire të efikasitetit në punë, me votim të hapur Kuvendi miratoi këtë rend dite, si dhe me votim të hapur deri tek pika 5 Komisionet e propozuar u zgjodhën me votim të hapur/aklamacion

1.-Propozimi dhe zgjedhja e dy (2) procesmbajtësit të punimeve të Kuvendit;

2.-Propozimi dhe zgjedhja e pesë (5) anëtarëve të kryesisë së punës;

3.- Propozimi për zgjedhjen e Komisionit verifikues prej (3) anëtarëve;

4.- Propozimi për zgjedhjen e Komisionit kandidues prej (3) anëtarëve;

5.- Propozimi për zgjedhjen e Komisionit zgjedhor prej (5) anëtarëve;

6.Propozim për zgjedhjen e Kryetarit të partisë politike Guxo

Propozimi ishte që të shkohet me dy (2) kandidate ( dy bashkë kryetar/e)

Reagime nga disa delegate të Kuvendin të partisë politike pasi që ishte e pa qarte për ta si mund të udhëhiqet partia nga dy 2 kryetarë.

- **Sqarimet** i dha znj. Gërvalla-Schwarz tha se kemi disa shembuj të partive politike në Gjermani, që udhëheqin dy 2 kryetar, një parti politike.

Lidhur me piken e rendit të ditës, **për propozimin që ka të beje me zgjedhjen e dy bashkë Kryetareve të Guxo, ishin** dy (2) Kandidate e propozuar për Kryetar të Partisë Politike “Guxo”

1. Znj.Donika Gërvalla-Schwarz
2. Z.Faton Peci

Mënyra e votim ishte e fshehët, fletëvotim përmbante tri (3) opsione

1. Jam PËR Donika Gërvallës-Schwarz dhe Faton Peci si kryetare të Partisë Guxo
2. Jam KUNDËR Donika Gërvallës-Schwarz dhe Faton Pecit si kryetarë të Partisë Guxo
3. Abstenoj

Para kutisë së votimit u krijuan tollovi nga ana e delegateve dhe disa nga delegate votuan dhe jashtë kabinës së votimit që secili delegate mund ta vinte re se për cilin opsion votonte xx delegati nuk ishte mënyra e fshehët e votimit ashtu siç u propozua.

**Komisioni Zgjedhor**, pas përfundimit të procesit të votimit nga të gjithë delegatet filloi numërimin e votave: Komisioni konstatoi se:

- 490 vota pro
- 11 kundër
- 1 abstenim

**Komisioni Zgjedhor**, për bashkë kryesuesit para delegateve tregon për votat

- 408-fletevotime
- 404-të vlefshëm



- 4- të pavlefshme
- 373-delegate pro
- 23-kunder
- 3-apstenime

Lidhur me pikën e rendit të ditës, **për propozimin që ka të beje me zgjedhjen e Këshillit të Përgjithshëm**, Kuvendi pas konsultimit dhe votimit, në mënyrë të hapet/me ngritje dore, zgjedhën këshillin e përgjithshme me të gjitha vota pro, asnjë vote kundër dhe as një abstenim, zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm të GUXO, prej 75 anëtareve, me mundësin që totali të jetë 103, pas përfundimit të procesit edhe nëpër disa dege të PP-së Guxo.

Kryesia e punës, për Delegatet hodhën në votim propozimin për mënyrën e votimit dhe të njëjtit në mënyrë unanime votuan për mënyrën e hapet të votimit dhe zgjodhën Kryesinë prej 13 anëtareve, me dy (2) vota kundër.

Pas përfundimit për shqyrtimin pikave të rendit të ditës, tubimi i shpalli të përfunduara punimet e Kuvendit.

#### **Konstatim nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim nga monitorim i Kuvendit të pare themelues te Partisë Politike GUXO**

Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se Kuvendi i mbajtur me datën 07.09.2022, nga partia politike Guxo është thirrur në pajtim me nenin 14, të Statutit dhe ka pasur kuorum për zhvillimin e punimeve, sipas listës së dorëzuar me nënshkrimet e delegateve pjesëmarrës.

Zyra gjatë monitorimit nga sugjeruar se pika 6, e rendit të ditës për zgjedhjen e dy 2 Kryetareve të Partisë Politike, nuk është konform Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, neni 14 Statuti i partisë politike pika d) procedurat që duhet zbatuar **për zgjedhjen e kryetarit**, të anëtareve të organit më të lartë ekzekutiv ose zyrtareve të tjerë të zgjedhur të partisë.

Zyra gjatë monitorimit ka vënë re se mënyra e votimit edhe pse ishte aprovuar që votimi të jetë i fshehtë nuk ishte në tërësi i fshehtë disa delegatë votuan jashtë kabinës së votimit dhe shume lehet ishte e identifikueshëm se cili delegate voton pro e cili kundër apo abstenon.

Zyra gjatë shqyrtimit dhe verifikimit të të gjithë formularëve të miratuar nga KQZ-ja, e që lidhen dhe obligohen partitë politike t'i dorëzojnë në ZRPPC, janë të obligueshëm të nënshkruhen nga Kryetari i partisë politike.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, kontestojnë ndryshimet e Statutit në Kuvendin e mbajtur me datën 07.09.2022, nga Partia Politike Guxo, lidhur me zgjedhjen e dy kryetareve brenda një parti të vetëm politike të regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Formulari i Regjistrimit të Partisë Politike/ Emri dhe Mbiemri i Kryetarit të Partisë Politike
- Formulari i Azhurnimeve Vjetore/Nënshkrim i Kryetarit të Partisë Politike
- Formulari Financiar Vjetor dhe i Fushatës/Emri dhe Mbiemri i Kryetarit të Partisë Politike
- Formulari për Vazhdimin e Regjistrimit të Partisë Politike/Kryetari i Partisë Politike, Nenin 12, pika 12.6 i LZP-së
- Formulari i Pëlqimit të Koalicionit/Nënshkrim i Kryetarit të Partisë Politike.



Në këtë Kuvend e mbajtur, siç u theksua më lartë, partia politike prezantoi ndryshimin e Statutit, më saktësisht të nenit 17, ku përcaktohet se cili organ e zgjedh kryetarin dhe kompetencat e kryetarit. Ndryshimi i vetëm që ky nen pësoi është ndryshimi i fjalës Kryetari në Kryetari/ët. Më pas, delegatët pjesëmarrës të këtij Kuvendi gjithashtu votuan dy Kryetarë të kësaj partie që ishin, Donika Gërvalla Schwarz dhe Faton Peci.

Me datën 13 shtator 2022, përfaqësuesi i partisë politike Guxo ka dorëzuar në Zyrë materialet nga Kuvendi të cilat përfshijnë: Formularin për njoftimin e ndryshimeve, procesverbalin e Kuvendit, listën e pjesëmarrësve dhe Statutin e ndryshuar. Në Formularin për njoftimin e ndryshimeve, në pjesën ku duhet të nënshkruhet Kryetari, është nënshkruar Faton Peci. Sipas shpjegimit të përfaqësuesit të partisë politike Guxo, votimi i dy Kryetarëve ishte më shumë veprim politik dhe se në arenën politike Guxo do të përfaqësohet nga dy Kryetarë, Donika Gërvalla Schwarz dhe Faton Peci, të cilët janë votuar në Kuvend ndërsa ligjërisht Guxo përfaqësohet vetëm nga Faton Peci.

Në lidhje me përshtatshmërinë ligjore të rezultateve që kanë dalur nga Kuvendi i parë themelues i partisë politike Guxo të mbajtur me datën 7 shtator 2022, më saktësisht ndryshimin e nenit 17 të Statutit të partisë si dhe votimi i dy kryetarëve, Zyra vlerëson që ndryshimi i Statutit të partisë politike për të lejuar partinë të ketë më shumë se një Kryetarë, është shkelje e Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, më saktësisht e çdo neni ku përmendet Kryetari si një person i vetëm. Pra kjo Rregull në asnjë nen nuk e thekson mundësinë që një parti politike e regjistruar mund të ketë më shumë se një Kryetar. Përpos kësaj, të gjitha dokumentet zyrtare të Zyrës, duke filluar nga ato për përmbushjen e obligimeve të rregullta deri te ato zgjedhore, kërkohet nënshkrimi i një Kryetari dhe Zyra ligjërisht e njeh vetëm një Kryetar të një partie politike.

Duke u nisur nga çfarë u tha më lartë, në përputhje me nenin 14, paragrafi 3 i Rregullës 01/2013 i cili thekson se ndryshimi i Statutit të partisë politike që nuk është në përputhje me këtë Rregull, është i pavlefshëm, Zyra konstaton se ndryshimet e Statutit të partisë politike Guxo që kanë dalur nga Kuvendi i parë themelues i datës 7 shtator 2022, janë të pavlefshme dhe rrjedhimisht votimi i dy Kryetarëve konsiderohet si i pavlefshëm.

Zyra rekomandon që, Statuti legjitim i partisë politike Guxo të konsiderohet ai me të cilin është regjistruar partia politike dhe brenda afatit prej dyzet e pesë (45) ditëve partia politike Guxo të sigurojë zgjedhjen e një Kryetari të vetëm të partisë politike në përputhje me Statutin e partisë politike.